

Fletëpalosja i dedikohet nënave vetë-ushqyese dhe fëmijëve të tyre me qëllim të realizimit të të drejtave që iu garantohen me Ligjin për Familjen dhe ligjet e tjera përkatëse në Republikën e Kosovës.



P o r o s i t ë:

Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Heshtja nuk është zgjidhje.

Mëso, kërko dhe realizo të drejtat tua dhe të fëmijës.

Vendos dhe mos u dorëzo.

Projekti “Mbështetja institucionale për nevojat e nënave vetë-ushqyese dhe fëmijëve të tyre.”, i financuar nga: BE-ja, i menagjuar nga INDEP e Fondacioni për Iniciativat Qytetare (FIQ), dhe i realizuar nga: Shoqata e Juristëve NORMA.

Shoqata e Juristëve NORMA ka këtë mision:

Promovimi i të drejtave të njeriut;
Reagimi kundër çdo lloj cenimi të të drejtave të njeriut;
Ngritja e vetëdijes për barazinë gjinore;
Ndikimi në nxjerrjen, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve

KONTAKTI:

Shoqata e Juristëve NORMA
Adresa: Shoqata e Juristëve
NORMA, Rr. “Svetozar Markoviq”,
nr.3/1, Prishtinë.
Email:shnorma@hotmail.com
www.norma-ks.org



European
Union
Kosovo

**MBËSHTETJA
INSTITUCIONALE
PËR NEVOJAT E
NËNAVE VETË-
USHQYESE DHE
FËMIJËVE TE TYRE**



FIQ

Forumi për
Iniciativat Qytetare
Forum for
Civic Initiatives



Korniza ligjore e mbrojtjes sociale dhe familiare

LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS - 2004/32- LIGJI NR. 06/L-077

Neni 7.1 – “Për realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet familjare, nënës dhe fëmijës u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale”. Pra, kur nëna dhe fëmijët nuk kanë mjete materiale, një e drejtë e tillë për mjete të domosdoshme për mirëqenie sociale mund të kërkohet në organin kompetent, respektivisht, në Qendrën për punë sociale. Kjo e drejtë duhet zbatuar gjithmonë në lidhshmëri me ligjet e veçanta.

LIGJI PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE - Nr. 04/L-081

Neni 1.3. Familje në nevojë - konsiderohet ajo familje kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit ose prindërve të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë

LIGJI PËR SKEMËN E ASISTENCËS SOCIALE NË KOSOVË - 2003/15- LIGJI NR. 04/L-096

Neni 1. Me këtë ligj rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë, me qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet që janë në varfëri.



LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI

Neni 2. Gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës.

LIGJI NR. 03/L-182 PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

Neni 1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

LIGJI NR. 04/L-017 PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Neni 1. Ky ligj ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

KUJT T'I DREJTOHESH?

GJYKATA

Padia për mbajtje financiare parashtrohet në Gjykatën Themelore - ku paditësi/ja e ka vendbanimin. Për kërkesën për mbajtjen e fëmijës, gjykata gjithmonë, vendos sipas detyrës zyrtare. Vendimi gjyqësor i plotfuqishëm, duhet të zbatohet nga pala e detyruar në bashkëpunim me punëdhënësin. Për përmbarimin e vendimeve gjyqësore, duhet të ushtrohet propozim për përmbarim në Gjykatën e cila e ka nxjerrë vendimin. Në procedurën e përmbarimit, gjykata ka për detyrë të veprojë me urgjencë.

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është organ i pavarur dhe përgjegjës për sigurimin e Ndihmës Juridike Falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në bazë të kriterëve kualifikuese, që përcaktohen nga Ligji për Ndihmë Juridike Falas.

Adresa: Zyra Qendrore për Ndihmë Juridike Falas, Rr. "ZenelSalihu", nr. 30, Prishtinë.

Kontakti: 038 200 18 936 / web: www.knj-rks.org

QENDRA PËR PUNË SOCIALE - Organi i Kujdestarisë

Në emër të fëmijës së mitur mund të inicioi dhe të përfaqësoi në procesin gjyqësor. Mund të kërkojë përmbarimin e vendimit të formës së prerë në procedurën e përmbarimit, në rast se prindi nuk kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës për alimentacion. Të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë fare në seancat gjyqësore. Organi i Kujdestarisë është i detyruar që t'i inkurajoi fëmijët dhe prindërit që të lidhin marrëveshje jashtëgjyqësore.

KOMISIONI PËR NDËRMJETËSIM

Komisioni për Ndërmjetësim ofron ndërmjetësimin – procedurë jashtë gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Anëtarët e familjes, nëse pajtohen, mosmarrëveshjet e tyre mund t'i zgjidhin në procedurën jashtëgjyqësore, të cilën e ofron Komisioni për Ndërmjetësim. Adresa: Zyra Qendrore, Prishtinë. Kontakti: 038 200 18 816 / email: ndermjetesimiprishtine@gmail.com